

156
08/08/10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 124, datë 17.2.2010

P Ë R

HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË,
NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Hapjen, në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, të programeve të studimit të ciklit të parë, në Fakultetin e Shkencave Teknike, si më poshtë:
 - a) “Biologji”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë, DNP, në biologji”.
 - b) “Fizikë”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë, DNP, në fizikë”.
 - c) “Kimi”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë, DNP, në kimi”.
 - d) “Ekonomiks”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë, DNP, në ekonomiks”.
 - e) “Financë”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë, DNP, në financë”.
 - f) “Inxhinieri elektrike”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë, DNP, në inxhinieri elektrike”.

2. Këto programe studimi të ciklit të parë realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është tre vite akademike.
3. Programet e studimit “Biologji”, “Fizikë”, “Kimi”, “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Inxhinieri elektrike” të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.
4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë.
5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

MYQEREM TAJAJ

